



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 22 Gusht 2018

NJOFTIM

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë përmes këtij Njoftimi e informon opinionin në lidhje me Kërkesën e parashtruar për mjekim spitalor jashtë shtetit për të siguarin K.B për fëmijën K.E., në të njejtën kohë duke Ju shprehur ngushëllimet më të thella familjes për humbjen e jetës së fëmiut të tyre.

I siguruari K.B për fëmijën K.E tek Fondi i shëndetësisë ka parashtruar Kërkesë për mjekim jashtë shtetit UP1 nr. 10-170 nga data 25.06.2018 si dhe të bashkangjitur me Kërkesën ka parashtruar edhe Propozimin për mjekim jashtë vendit dhe Mendim për mjekim jashtë shtetit për rast vdekjeprurës, nga këshilli profesional i Klinikës për sëmundje të fëmijëve në Shkup me nr. 0403-6/603 nga data 21.06.2018.

Kërkesa është shqyrtuar nga të dyja seancat e komisionit mjekësor për mjekim jashtë shtetit dhe gjatë kohës së grumbullimit të dokumenteve të nevojshme mjekësore në bazë të së cilave jepet vendimi, komisioni mjekësor me datë 27.06.2018 dha përgjigje dhe vlerësim përfundimtar në bazë të së cilës, Fondi me datë 28.06.2018 (UP1 nr. 10-170) e miratoi vendimin për tu mjekuar pacienti jashtë shtetit respektivisht në institucionin shëndetësor Gaziosman Pasa në Istanbul, Turqi për gjithsej 150 ditë qëndrimi, duke mbuluar zbatimin e kimioterapisë dhe transpantin e palcës së kockave prej donator potencial jofamiljar, me shpenzime totale në vlerë prej 145.000 euro, me shoqërues gjatë shkuarjes dhe kthimit nga mjekimit. Për shkuarjen për mjekim është miratuar fluturimi me aeroplan sanitar, shpenzimet e së cilës do të konsideroheshin në procedurë të veçantë ndërsa gjatë kthimit, fluturimi me aeroplan. Para prurjes së vendimit, sipas procedurës ligjore, pacienti e realizoi pagesën e participimit në vlerë jo më të lartë se 200 euro në kundërvlerë në denarë respektivisht 12.300 denarë.

I siguruari me datë 06.07.2018 (UP2 nr. 02-37) ka parashtruar ankesë deri tek organi i shkallës së dytë respektivisht tek Bordi Zgjedhor i Fondit. Bordi Zgjedhor përmes Komisionit mjekësor të shkallës së dytë, e ka shqyrtuar ankesën e të siguarit bashkë me dokumentacionin mjekësor dhe i njëjti e ka vërtetuar vendimin e organit të shallës së parë, duke sjellë vendim me datën 12.07.2018 (UP2 nr.02-37).

Në pajtueshmëri me rregullat ligjore dhe rregulloret si dhe nga sqarimi i lartëpërmendur, Fondi për sigurim shëndetësor ka vepruar në bazë të kërkesës së personit të siguar dhe e ka miratuar mjekimin e tij jashtë vendit.